



BASHKIA TIRANË
Qendra Komunitare Multidisiplinare

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: KLODIAN ALIKO PF me adresë Rruga :”Kryqëzimi i rrugës Qemal Stafa me rrugën Ludovik Shllaku ”, Vila me Nr.3/35, 3/398, ZK. 8150, TIRANE

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim, Marrveshje Kuadër

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81738-12-10-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ”Funizim dhe shërbime me ushqim për mencent“ nga momenti i nënshkrimit të kontrata / për 12 muaj.

Publikime të mëparshme (*ska patur*):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria NELSA shpk me nr NIPTI: J71601012S me një vlerë ekonomike prej 2.509.056 (dy milion e pesëqind e nëntë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) leke pa TVSH
2. Shoqeria Klodian Aliko PF me nr NIPTI: L52028093R, me një vlerë ekonomike prej 2.750.000 (dy milion e shtatë qind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.Të skualifikojë operatorin ekonomik NELSA shpk për arsye se:

Komisioni i Vleresimit te Ofertave gjatë shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave në sistemin elektronik konstatoi se operatori ekonomik “Nelsa” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipërcituar ka paraqitur mjetin me targa AA 416 DF por nuk ka paraqitur pajisjen izobox e cila mundëson ruajtjen e gjëndjes fillestare të cilësisë së ushqimit gjatë transportit dhe qëndron brenda mjetit të transportit të ushqimit. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues(faturë tatimore, inventar, foto etj) për disponimin e kësaj pajisje e cila është e domosdoshme gjatë transportimit të ushqimit. Duke qënë se qëllimi kryesor i këtij procesi është



BASHKIA TIRANË

Qendra Komunitare Multidisiplinare

sigurimi i ushqimit për target grupin vulnerabël të fëmijëve në situatë rruge dhe ushqimi ka impakt të drejtpërdrejtë në shëndetin e fëmijëve komisioni gjykon se operatori ekonomik duhet ta dispononte këtë pajisje në përmbushje të funksionit për të cilin është kërkuar.

Ne nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, 7 parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se KLODIAN ALIKO PF, me adrese: Rruga: ”Kryqëzimi i rrugës Qemal Stafa me rrugën Ludovik Shllaku”, Vila me Nr.3/35, 3/398, ZK. 8150, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2.750.000 (dy milion e shtatë qind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Qendres Komunitare Multidisiplinmare, Bashkia Tiranë me adrese: Rruga: “Maliq Muço”, Nr.19 Tiranë, me nr kontakti: 0694418904, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.12.2020

ANKESA: Në datën 05.01.2021 shoqëria NELSA SHPK me shkresën hyrëse nr 01 prot, datë 05.01.2021 ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor për procedurën e prokurimit Kërkese për propozim_marrëveshje kuadrër me objekt: “**Furnizim dhe shërbime me ushqim për mencat**”.

Ankesa është brenda afateve kohore ligjore të parashikuara dhe si e tillë është marrë në shqyrtim, nga ana jonë.



BASHKIA TIRANË
Qendra Komunitare Multidisiplinare

Duke ju referuar konstatimeve sipas kthim përgjigje nr 1 prot datë 07.01.2021, ju nuk i përmbushni kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Përsa më sipër, mbështetur në Nenin 63, kreu VII, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe Nenin 78, të VKM Nr.914, datë 29.12.2014, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", **ankesa është refuzuar si e pa bazuar në legjislacionin.**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

MATILDA ZIZOLLI

DREJTOR